



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. 78, datë 07/12 2021

Mbi miratimin e formës së kryerjes së shërbimit për mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe shërbimin e varrimit për njesitë e qytetit (lagja 1, lagja 2 dhe lagja 3) nga Bashkisa Berat.

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9220, date 15.04.2004 " Per Sherbimin Publik te Varrimit " i ndryshuar, Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, VKM nr. 629 date 15.07.2015 "Per miratimin e Manualeve Teknike te Çmimeve te Punimeve te Ndertimit dhe te Analizave Teknike te Tyre ", i ndryshuar, VKM Nr. 1025 , date 16.12.2020 " Per Percaktimin e Pages Minimale ne Shkalle Vendi " , VKM Nr. 712 , date 29.10.2014 " Per Miratimin e Rregulltores Teknike " Per Projektimin dhe Ndertimin e Varrezave ne Territorin e RSH " , Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", Urdherit te Kryetarit te Bashkise Nr. 509, date 15.09.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për studimin dhe përcaktimin e koston për shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave publike, e të Dëshmorëve dhe shërbimit të varrimit" i ndryshuar , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I :

- 1.Miratimin e formës së kryerjes së shërbimit për mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe shërbimin e varrimit për njesitë e qytetit (lagja 1, lagja 2 dhe lagja 3) nga Bashkisa Berat.
2. Efektet financiare fillojne 01.01.2022 .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës , Ndermarrja vartese e Bashkise qe do te kryej sherbim e mesiperm.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 6207 prot.

Berat , më 06.12.2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projektvendimin dhe relacionin shoqërues

Mbi miratimin e formës së kryerjes së shërbimit për mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve dhe shërbimin e varrimit për njesitë e qytetit (lagja 1, lagja 2 dhe lagja 3) nga Bashkisa Berat.

KRYETARI

Ervin DEMO

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtor i Drejtorisë Juridike

Erlin Kuçi,: Drejtor i Emergjencave Civile ,Pronave ,Transportit dhe Sherbimeve

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 4


STUDIM

Mbi përcaktimin e kostos për shërbimin e Mirëmbajtjes së Varrezave Publike, Mirëmbajtjes së Varrezave të Dëshmorëve dhe Shërbimin e Varrimit, në Bashkinë BERAT

(Shërbimi i ofruar nga Bashkia Berat)

**Miratohet
Kryetari i Bashkisë**

Ervin DEMO



Nëntor 2021

PËRMBAJTJA:

1. BAZA LIGJORE
2. HYRJE
3. QËLLIMI I STUDIMIT

4. SITUATA AKTUALE E OFRIMIT TË SHËRBIMIT
5. MATERIALI SHPJEGUES I ZËRAVE TË SHËRBIMEVE PJESË E KOSTOS TOTALE
6. PASQYRAT PËRBLLEDHËSE E ANALIZËS SË KOSTOS
7. KOSTO PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË PËRCAKTUARA
8. SPECIFIKIMET TEKNIKE
9. SHËNIME TË PËRGJITHËSHME SHPJEGUESE

GRUPI I PUNËS

▪ Luçiano	Bojaxhiu	Kryetar
▪ Arjan	Shkembi	Anëtar
▪ Erlin	Kuçi	Anëtar
▪ Denada	Gjogu	Anëtar
▪ Ergi	Gjymshana	Anëtar
▪ Edona	Baro	Anëtar
▪ Llazar	Hoxholli	Anëtar
▪ Rovena	Shehu	Anëtar
▪ Sokol	Toska	Anëtar
▪ Miltiadh	Kushi	Anëtar
▪ Petro	Sinjari	Anëtar
▪ Erinda	Toto	Anëtar
▪ Anxhelo	Dhima	Anëtar
▪ Frenci	Ceca	Anëtar
▪ Dejani	Zylyftari	Anëtar
▪ Jorida	Papa	Anëtar
▪ Mirel	Konomi	Anëtar
▪ Joana	Melengu	Anëtar
▪ Kliti	Koroni	Anëtar
▪ Englinson	Qose	Anëtar
▪ Shkelqim	Hadaj	Anëtar
▪ Admir	Grembi	Anëtar
▪ Mirjan	Dalipaj	Anëtar

1. BAZA LIGJORE

- Ligji Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.
- Ligji Nr.9220, datë 15.4.2004 "Per Sherbimin Publik te Varrimit", i ndryshuar.
- VENDIM Nr. 629, datë 15.7.2015 "Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të Tyre", i ndryshuar.
- LIGJ Nr.9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën E Shqipërisë", i ndryshuar.
- VENDIM Nr. 1025, datë 16.12.2020 "Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi".
- VENDIM Nr. 712, datë 29.10.2014 "Për Miratimin e Rregullores Teknike për Projektimin dhe Ndërtimin e Varrezave në Territorin e Republikës së Shqipërisë".
- UDHËZIM Nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar.
- LIGJ nr.68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore".
- URDHËRIT të Kryetarit të Bashkisë Nr. 509, date 15.09.2021 "Për ngritjen e grupit të punës për studimin dhe përcaktimin e kostos për shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave publike e të Dëshmorëve dhe shërbimit të varrimit" i ndryshuar.

2. HYRJE

Bashkia e Beratit shtrihet në krahinën malore të Shqipërisë jugore dhe pjesërisht në ultësirën perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të Lumit Osum, i cili kalon përmes qytetit të Beratit. Shtrirja në këto dy krahinat të ndryshme fiziko - gjeografike, ndikon në ndryshueshmërinë e relievit të territorit, të kushteve fizikogjeografike nga perëndimi në lindje e nga veriu në jug, e të peisazheve gjeografike. Bashkia Berat përfshin brenda juridiksionit të saj administrative qytetin e Beratit, njësitë Roshnik, Otlak, Velabisht dhe Sinjë.



Bashkia Berat kufizohet në veri me Bashkinë Kuçovë, në lindje me Bashkinë e Gramshit, në juglindje me Bashkinë Poliçan e Skrapar, në perëndim me Bashkinë Mallakastër e Fier. Bashkia Berat, është qendra më e rëndësishme, demografike, administrative dhe ekonomike e Qarkut Berat.

Bashkia Berat ka një sipërfaqe prej 382.1 km² prej së cilës sipërfaqe urbane janë 19 km².

Per te siguruar nje sherbim me cilësor, per te kalkuluar nje kosto te plote te ketyre dy sherbimeve si dhe per te realizuar nje ekonomizim te perdorimit te fondeve ne dispozicion, grupi i punes i nfritur per kete qellim, hartoi kete studim.

3. QËLLIMI I STUDIMIT

Studimi për përcaktimin e kostos vjetore për shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe varrezat e dëshmorëve dhe shërbimin e varrimit të ofruar nga Bashkia Berat është punuar duke marrë në konsideratë përgjegjësin për krijimin e kushteve më të mira dhe plotësimin me bazë materiale të domosdoshme për ritjen e shërbimit.

Forma e dhënies së shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve dhe të shërbimit të varrimit nëpërmjet Bashkisë Berat është më efiçent dhe më cilësor. Për shkak të implementimit edhe të ligjit nr.115/2014 “Për Zbatimin e Reformës Territoriale Administrative” ky shërbim do të përfshijë gjithë territorin e Bashkisë Berat, duke ofruar shërbim me cilësi shtesë në mirëmbajtjen e varrezave publike nëpër fshatra.

Gjithashtu gjatë viteve 2016-2021 janë kryer aplikime për zgjerime të sipërfaqeve të varrezave publike nëpërmjet shpronësimeve për interes publik, realizimi i të cilit ka qënë një domosdoshmëri për shkak të mungesës së sipërfaqeve të lira në varrezat ekzistuese, duke shkaktuar problem me menaxhimin e rasteve kur banorët ndërrojnë jetë. Gjithashtu studimi i kryer është realizuar duke marrë parasysh përditësimet ligjore për kostot dhe pagat.

4. SITUATA AKTUALE E OFRIMIT TË SHËRBIMIT

Aktualisht, shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të Dëshmorëve në Bashkinë Berat nga nëntori i vitit 2016 e në vijim është kryer nëpërmjet kontraktuesit “AB. ZOGA” sh.p.k & “PIENVIS” sh.p.k.

Kontrata e sipërmarrjes për këtë shërbim është realizuar nëpërmjet procedurave të prokurimit publik dhe me një afat kohor 5-vjeçar.

Afati i përfundimit të kontratës është 11 Nëntor 2021. Për arsye të përfundimit të afatit, është ngritur grupi i punës i cili kalkuloi koston e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të varrezave të Dëshmorëve, të shërbimit të varrimit për qytetin me objektiv për ta shtrirë këtë shërbim në të gjithë territorin e bashkisë.

Sipërfaqja totale e varrezave publike në Bashkinë e Beratit është 657,684 m², kurse sipërfaqja e varrezave të Dëshmorëve është 4,190 m². Të dhënat analitike për secilin prej rajoneve dhe njësive administrative janë të pasqyruara në pasqyrat përmbledhëse të analizës së koston.

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur kostoja e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të Dëshmorëve gjatë viteve 2016-2021 dhe numri i vdekjeve sipas Gjëndjes Civile Berat.

- Pasqyrë përmbledhëse për koston e Mirëmbajtjes së Varrezave Publike, Mirëmbajtjes së Varrezave të Dëshmorëve të Bashkisë Berat në vitet 2016-2021.

Vitet	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Kosto e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të Dëshmoreve	3,497,561	3,251,536	3,336,235	1,713,501	3,258,165	3,676,257
TOTALI	3,497,561	3,251,536	3,336,235	1,713,501	3,258,165	3,676,257

Në tabelën e mësipërme vlen të theksojmë :

Kostot në vite përfaqësojnë koston e shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe varrezave të dëshmorëve.

Kostoja e shërbimit të varrimit nuk është e pasqyruar në të dhënat e tabelës së mësipërme, pasi ky shërbim nuk ka qënë pjesë e vlerës së prokuruar dhe të kontraktuar.

- Numri i vdekjeve gjatë viteve 2019-2021.

Bashkia	Rajoni/Njësia	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Totali
BERAT	Rajoni 1	111	144	103	358
	Rajoni 2	130	165	115	410
	Rajoni 3	101	148	105	354
	Njësia Administrative Sinjë	21	30	25	76
	Njësia Administrative Roshnik	16	22	18	56
	Njësia Administrative Velabisht	79	85	50	214
	Njësia Administrative Otlak	86	94	69	249
	Totali		544	688	485

5. MATERIALI SHPJEGUES I ZËRAVE TË SHËRBIMEVE PJESË E KOSTOS TOTALE

Zërat e Shërbimeve për mirëmbajtjen e :

a) Varrezave publike

- Ruajtja e varrezave
- Pastrim e prerje bari (2 herë/vit)
- Ujitje bimësh dekorative
- Mirëmbajtje parcele ekzistuese
- Pastrim rruge e sheshe

b) Varrezave të deshmorëve

- Ruajtja e varrezave
- Pastrim e prerje bari
- Mirëmbajtje lule dekorative
- Pastrim rruge e sheshe
- Mirëmbajtje parcele ekzistuese
- Rifreskim i gërmave 1 herë/vit
- Pastrim varri prej mermeri vendi 2 herë/vit
 - Varr prej mermer/ granit vëndi (varret e vjetra)
 - Varr prej mermeri me shkëlqim (varret e reja)

Zërat e Shërbimeve për Shërbimin e varrimit për varrezat Burdullias, Suelas dhe Dëshmorëve:

- Varrim me varr të ri, persona me moshë deri në 10 vjeç
- Varrim me varr të ri, persona me moshë mbi 10 vjeç
- Varrim me zhvarrim pa qivure, persona me moshë deri në 10 vjeç
- Varrim me zhvarrim pa qivure, persona me moshë mbi 10 vjeç
- Varrim me zhvarrim me qivure, persona me moshë deri në 10 vjeç
- Varrim me zhvarrim me qivure, persona me moshë mbi 10 vjeç
- Zhvarrim pa qivur
- Zhvarrim me qivur

6. PASQYRAT PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS SË KOSTOS

- Pasqyrë përmblledhëse të dhënave bazë për analizën e kostos për mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të Dëshmorëve

Nr	Emertimi	Sip. Totale m2	Sip e lire m2	Sip. Rruge&sheshe m2	Sip. Bime dekorative m2	Parcela
I	Varrezat publike	657,684	260,485	5,799	1,000	116
1	Suelas (Rajoni 3)	80,245	46,865	4,115	500	80
2	Burdullias (Rajoni 1)	35,380	11,658	1,684	500	35
3	Nj.A. Otlak	102,806	38,578			
4	Nj.A. Velabisht	123,933	46,487			
5	Nj.A. Sinje	255,535	94,437			
6	Nj.A. Roshnik	59,785	22,460			
II	Varrezat e Dëshmoreve	4,190		1,754	1,610	4

Shënojmë se Sipërfaqja e varrezave është shtuar në vite si rezultat i shpronësimeve të bëra.

- Pasqyrë përmblledhëse e bazës së të dhënave për analizën e kostos për mirëmbajtjen e varrezave publike, Bashkia Berat

Nr	Emertimi i Sherbimeve	Njesia e matjes	Sasia	Bashkia qyteti			NJA Otlak	NJA Velabisht	NJA Roshnik	NJA Sinjë
				Bashkia	Burdullias	Suelas				
1	Ruajtja e varrezave	dite	365	365	365	365				
2	Pastrim e prerje bari	m ²	260,485	58,523	11,658	46,865	38,578	46,487	22,460	94,437
3	Ujitje bimësh dekorative	m ²	1,000	1,000	500	500				
4	Mirëmbajtje parcele ekzistuese	parcela	116	116	35	80				
5	Pastrim rrugë e sheshe	m ²	5,799	5,799	1,684	4,115				

- Pasqyrë përmblledhëse e bazës së të dhënave për analizën e kostos për mirëmbajtjen e varrezave të Dëshmorëve

Nr.	Emertimi i Sherbimeve	Njesia	Sasia
1	Ruajtja e varrezave	dite	365
2	Pastrim e prerje bari	m ²	1,610
3	Mirembajtje lule dekorative	m ²	1,610
4	Pastrim rruge e sheshe	m ²	1,754
5	Mirembajtje parcele ekzistuese	parcela	4
6	Rifreskim i germave	germa	8,000
7	Pastrim varri prej mermeri		
	• Varr prej mermer/granit vendi (varret e vjetra)265 varre	cope	265
	• Varr prej mermeri me shkelqim (varret e reja), 21 varre	cope	21

7. KOSTO PËR KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË PËRCAKTUARA

- a. Kosto Personeli
- b. Kosto Materiale dhe të tjera kosto operative
 - Materiale për shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve
 - Materiale për shërbimin e varrimit
- c. Kosto Vegla Pune, mjete pune, me afat përdorimi mbi 1 vit

a. Kosto Personeli:

Numri i nevojshëm i personelit:

- Për ruajtjen e varrezave nevojiten 6 roje
- Për kryerjen e shërbimeve të tjera të mirëmbajtjes nevojiten 1 punëtor shërbimesh në varrezat Suelas, 1 punëtor shërbimesh në varrezat Burdullias, 1 punëtor shërbimesh në varrezat e Dëshmorëve, si edhe nga 1 punëtor shërbimesh në çdo NJA.
Total punëtorë shërbimesh: 7 punëtorë
- Punëtor për shërbimin e varrimit (varrmihës): 4 punëtorë
- Mbikqyrës i shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dëshmorëve: 1 mbikqyrës

Struktura e personelit dhe niveli i pagave :

Nr.	Emertimi sipas structures	Nr. punonjes	Arsimi	Klasa + kateg	Paga e Grupit	Shtesa për Vjetërsi në %	Shtesa për Pozicion	Paga mujore maximale
1	Mbikqyrës i shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave	1	I lartë	III-b	1 ose 2	2%	49,000	70,000
2	Roje në varrezat publike Suelas	2	I mesëm/ 8-9 vjeçar	II		1%	31,600	39,500
3	Roje në varrezat publike Burdullias	2	I mesëm/ 8-9 vjeçar	II		1%	31,600	39,500
4	Roje në varrezat e Dëshmoreve	2	I mesëm/ 8-9 vjeçar	II		1%	31,600	39,500
5	Punëtor shërbimi për mirëmbajtjen e varrezave bashki qytet	3	I mesëm/ 8-9 vjeçar	II		1%	31,600	39,500
6	Punëtor shërbimi mirëmbajtje në NJA	4	I mesëm/ 8-9 vjeçar	II		1%	31,600	39,500
7	Punëtor i shërbimit të varrimit në varrezat e qytetit (varrmihës)	4	I mesëm/ 8-9 vjeçar	II		1%	31,600	39,500
	Total	18						

Kosto vjetore e personelit :

Nr	Emertimi sipas strukturës	nr punonjes	paga mujore	Shtesa mbi page 15%	sigurimet mujore 16.7%	kosto vjetore	Sherbimi i mirembajtjes se varrezave	Sherbimi i varrrimit
1	Mbikqyres i sherbimit te mirembajtjes se varrezave	1	70,000	0	11,690	980,280	490,140	490,140
2	Roje ne varrezat publike Suelas	2	39,500	5,925	7,586	1,272,263	1,272,263	
3	Roje ne varrezat publike Burdullias	2	39,500	5,925	7,586	1,272,263	1,272,263	
4	Roje ne varrezat e Deshmoreve	2	39,500	5,925	7,586	1,272,263	1,272,263	
5	Punetor sherbimi per mirembajtjen e varrezave	3	39,500	0	6,597	1,659,474	1,659,474	
6	Punetor sherbimi mirembajtje ne NJA	4	39,500	0	6,597	2,212,632	1,106,316	1,106,316
7	Punetor i sherbimit te varrrimit ne varrezat e qytetit(varrmihes)	4	39,500	0	6,597	2,212,632		2,212,632
	Total	18				10,881,808	7,072,720	3,809,088

b. Materiale dhe të tjera kosto operative

▪ Materiale për shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	Sasia vjetore	cmim/njesi	Kosto vjetore lek
1	Veshje pune profesionale me shirita fosforeshente (kominoshe), me material pambuku	palë	13	1,290	16,770
2	Çizme pune të shkurtra shiu, me material PVC	palë	13	1,200	15,600
3	Doreza pune me veshje lëkure	palë	13	290	3,770
4	Pelerinë shiu me shirit fosforeshent, me material PVC	copë	13	895	11,635
5	Fshesë plastike	copë	18	229	4,122
6	Bisht per fshese plastike	copë	18	199	3,582
7	Furçë teli	copë	20	130	2,600
8	Beze/ tekstil per pastrimin e varreve te deshmoreve	kg	57	100	5,720
9	Neft	copë kuti	10.0	200	2,000
10	Varak sprite	kuti	40.0	250	10,000
11	Zorrë plastike për vaditje	cope rulon	3	500	1,500
12	Rekorderi plastike	copë	6	150	900
13	Plehra kimike (NPK)	kg	80	900	72,000
14	Ure	kg	65	100	6,500
15	Nitrat	kg	25	90	2,250
16	Foliar (Gjethore)	litra	2.00	1,000	2,000
17	Pesticide (Insekticide, afide)	litra	0.50	4,000	2,000
18	Funkicid për spërkatjen 3here te bimëve dhe luleve (kundervrugut)	kg	5.0	2,700	13,500
19	Funkicid për spërkatjen 3 here te bimëve dhe luleve (kunder hirit)	litra	0.5	6,000	3,000
20	Funkicid për spërkatjen 1 here te bimëve dhe luleve (kunder merimangave)	litra	0.5	8,000	4,000
21	Uje per vaditje, 30m3/1000m2	m3	1,253	156	195,468
22	Stabilizant cakull 10 cm, per shtrimin e rrugeve 200m2	m ³	20	600	12,000
	Shuma				390,917
	Te tjera operative 1%				3,909
	Total Materiale dhe te tjera operative				394,826

▪ **Materiale për shërbimin e varrimit**

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	Sasia vjetore	cmim/njesi	Kosto vjetore lek
1	Pllaka betoni për ndërtimin e varrit, permasa cm 55x75x4, cope 2	set	500	7,500	3,750,000
	Pllaka betoni per mbulimin e varrit(kapak), permasa cm 85x45x4, cope 5				
	Pllaka betoni anesore per konfigurimin e varrit, permasa cm180x20x4, cope2				
	Pllaka betoni ballore, me permasa cm90x20x4, cope 2				
	Koka varri prej llamarine cm20x40, trashesi 0.5mm, cope 1	copë	500	500	250,000
2	Veshje pune profesionale me shirita fosforeshente (kominoshe), me material pambuku	palë	4	1,290	5,160
3	Çizme pune të shkurtra shiu, me material PVC	palë	4	1,200	4,800
4	Doreza pune me veshje lëkure	palë	4	290	1,160
5	Pelerinë shiu me shirit fosforeshent, me material PVC	copë	4	895	3,580
6	Bojë vaji e zezë	litra	20	300	6,000
7	Bojë vaji e bardhë	litra	10	300	3,000
8	Furcë për lyerje te kokave te varrit me bojë vaji te zeze	copë	8	100	800
9	Penel për shkrimin e emrave me bojë vaji te bardhe	copë	8	100	800
10	Neft	copë	5	200	1,000
11	Litar për mbajtjen e arkivolit	metër linear	200	150	30,000
12	Ganxha prej hekuri per vendosjen e kapakeve te varrit,	copë	8	200	1,600
13	Dizinfektant per eshtrat (klor pluhur)	kg	50	150	7,500
14	Këllëf tekstili për paketimin e eshtrave , cm 55 x 80	copë	130	300	39,000
Shuma					4,104,400
Te tjera operative 1%					41,044
Total Materiale dhe te tjera operative					4,145,444

Shënim : Është marrë numri mesatar i vdekjeve 2019-2020 dhe 8-mujori 2021.

c) Vegla pune, pajisje, mjete

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi/ njesi	Vlera Lek	Sherbimi i mirembajtjes se varrezave		Sherbimi i varrimit	
						Sasia	Vlera Lek	Sasia	Vlera Lek
1	Karrocë dore metalike (me peshë mbajtëse deri ne 100 Kg) (2 ne suelas, 1 ne burdullias, 1 tek deshmoret, 4 njesite)	copë	8	4,400	35,200	4	17,600	4	17,600
2	Gërshërë metalike manuale për prerje bari/krasitje	copë	1	990	990	1	990		
3	Kosë bari prej celiku special me bisht druri (me gjatësi tehu 650mm)	copë	7	1,000	7,000	7	7,000		
4	Krehër bari metalik me bisht druri	copë	7	800	5,600	7	5,600		
5	Bel çeliku me bisht druri	copë	7	650	4,550	3	1,950	4	2,600
6	Prashitës metalik për bimë dhe lule me dy krahë	copë	7	450	3,150	3	1,350	4	1,800
7	Lopatë katrore celiku me bisht druri	copë	11	800	8,800	3	2,400	8	6,400
8	Kazma per germimin e gropave	copë	8	700	5,600		0	8	5,600
9	Skrapello	copë	2	450	900			2	900
10	Levë	copë	2	2,530	5,060			2	5,060
11	Matrapik	copë	1	8,500	8,500			1	8,500
	Total				85,350		36,890		48,460

KOSTO TOTALE VJETORE E SHËRBIMIT TË MIRËMBAJTJES SË VARREZAVE DHE SHËRBIMIT TË VARRIMIT

Nr	Emertimi	Shuma Lek	Sherbimi i mirembajtjes	Sherbimi i varrimit
1	Kosto Personeli	10,881,808	7,072,720	3,809,088
2	Kosto Materiale	4,540,270	394,826	4,145,444
2.1	<i>Mat. per mirembajtjen e varrezave</i>	394,826	394,826	
2.2	<i>Mat. per sherbimin e varrimit</i>	4,145,444		4,145,444
3	Kosto Vegla, mjete pune	85,350	36,890	48,460
	Total kosto (1+2+3)	15,507,428	7,504,436	8,002,992

8. SPECIFIKIMET TEKNIKE

a. Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dëshmorëve konsiston në:

- **Ruajtje e varrezave publike.** Ky është një proces pune në vazhdimësi për gjithë vitin 365 ditë dhe përfshin ruajtjen e territorit të varrezave “Suelas”, “Burdullias” dhe “Dëshmorëve”. Ky zë nënkupton ruajtjen e varrezave publike dhe të Dëshmorëve për 12 orë në ditë.
- **Pastrim dhe prerje bari 2 herë në vit.** Në këtë zë punimi nënkuptohet pastrim dhe prerja e barit 2 herë në vit në varrezat publike (përfshirë edhe NJA) dhe 1 herë në vit në varrezat e Dëshmorëve, me mjete korrëse dore dhe mjete motorike për transportin e barit. Ky proces pune do të realizohet gjatë muajve Maj-Gusht. Sipërfaqja totale e varrezave publike është 657,684 m² dhe sipërfaqja e varrezave të dëshmorëve është 4,190 m². Ky shërbim do të kryhet në varrezat publike për sipërfaqen 260,485 m², 2 herë në vit (total 520,970 m²); Në varrezat e dëshmorëve ky shërbim do të kryhet për sipërfaqen 1,610 m².
- **Ujitje bimësh dekorative.** Ky proces pune nënkupton ujitjen e bimëve dekorative dhe luleve në vazhdimësi, ujitje e cila do të kryhet në periudhën Prill-Tetor në varrezat “Suelas” dhe “Burdullias”. Sipërfaqja për të dyja varrezat për procesin e punës “Ujitje bimësh dekorative” është 1000 m².
- **Mirëmbajtje parcele ekzistuese.** Është një proces pune që ka të bëjë me riparimin e bordurave dhe shtrimin e rrugëve me çakull stabilizant. Është një punë që bëhet në vazhdimësi për gjatë gjithë vitit. Numri i parcelave për të dyja varrezat “Suelas” dhe “Burdullias” është 116 parcela, ndërsa në varrezat e Dëshmorëve është 4 parcela.
- **Mirëmbajtje lule dekorative.** Ky proces pune kryhet në varrezat e Dëshmoreve dhe nënkupton dy punime me bel, ujitjen e bimëve dekorative në vazhdimësi, 6 herë prashitje të sipërfaqes së mbjellë me lule dhe bimë dekorative, pastrimin në vazhdimësi të parcelave dhe largimin në vazhdimësi të mbeturinave të grumbulluara. Sipërfaqja e mbjellë me bimë dekorative dhe lule është 1610 m².
- **Pastrim rruge dhe sheshe.** Është një proces pune që bëhet gjatë gjithë vitit dhe nënkupton pastrimin e rrugëve dhe shesheve me fshesa dore, për varrezat ‘Suelas’, ‘Burdullias’ dhe ‘Dëshmorët’. Mbeturinat mblidhen me lopata plastike dhe grumbullohen edhe më pas largohen në vëndet e paracaktuara nga Bashkia. Për të dyja varrezat “Suelas” dhe “Burdullias” është llogaritur rreth 5799 m² sipërfaqe, ndërsa në varrezat e Dëshmorëve është 1754 m². Theksojmë se rrugët dhe hapësirat midis varreve në brendësi të varrezave të jenë vazhdimisht të pastra.
- **Rifreskimi i gjermave të varrezave të Dëshmorëve.** Është një proces pune që bëhet një herë në vit, me varak (sprite). Mbas lysterjes bëhet pastrimi me neft dhe beze tekstili i kokave të varrit me qëllim që të mos mbeten shenja varaku në përfundim të punës.
- **Pastrim varri prej mermeri në varrezat e Dëshmorëve** është një proces pune që kryhet dy herë në vit me materiale përkatëse në mënyrë të tillë që mos të dëmtohen varret apo të lihen shënja gërvishitje mbi sipërfaqjen e mermerit.

Spektori që do të manaxhojë ofrimin e këtyre shërbimeve do të veprojë sipas një rregulloreje të brendshme.

b. **Shërbimi i varrimit në varrezat Suelas, Burdullias dhe të Dëshmorëve**

Shërbimi i varrimit në varrezat Suelas, Burdullias dhe te varrezat e Dëshmorëve është një proces pune që zhvillohet sipas natyrave (llojeve) të shërbimit të cilat janë :

- **Varrim me varr të ri, persona me moshë deri në 10 vjeç** nënkupton hapjen e varrit me përmasat e rekomanduara sipas VKM-së nr.712, datë 29.10.2014, në ndërtimin e varrit me elemente betoni, vendosjen e kufomës me arkivol, mbylljen e varrit me elemente betoni, mbulimin e varrit me dhe', vendosjen e bordurave prej betoni për konfigurimin e varrit dhe vendosjen e kokës së varrit me të dhënat e personit të vdekur. Vlera e këtij shërbimi shkon në 9,938 lekë.
- **Varrim me varr të ri, persona me moshë mbi 10 vjeç** nënkupton hapjen e varrit me përmasat e rekomanduara sipas VKM-së nr.712, datë 29.10.2014, në ndërtimin e varrit me elemente betoni, vendosjen e kufomës me arkivol, mbylljen e varrit me elemente betoni, mbulimin e varrit me dhe', vendosjen e bordurave prej betoni për konfigurimin e varrit dhe vendosjen e kokës së varrit me të dhënat e personit të vdekur. Vlera e këtij shërbimi shkon në 16,160 lekë.
- **Varrim me zhvarrim pa qivure, persona me moshë deri në 10 vjeç** nënkupton heqjen e bordurave të betonit, zbulimin e varrit, hapjen e varrit duke hequr kapakët e betonit, nxjerrjen dizinfektimin dhe paketimin e eshtrave në beze tekstili, heqjen e elementeve të betonit të varrit të vjetër, groposjen e mbeturinave të varrimit, ndërtimin e varrit të ri me elemente betoni, vendosjen e kufomës bashkë me eshtrat, mbylljen e varrit me elemente betoni, mbulimin e varrit me dhe', vendosjen e bordurave prej betoni për konfigurimin e varrit dhe vendosjen e kokës së varrit me të dhënat e personit të vdekur. Vlera e këtij shërbimi shkon në 11,968 lekë.
- **Varrim me zhvarrim pa qivure, persona me moshë mbi 10 vjeç** nënkupton heqjen e bordurave të betonit, zbulimin e varrit, hapjen e varrit duke hequr kapakët e betonit, nxjerrjen dizinfektimin dhe paketimin e eshtrave në beze tekstili, heqjen e elementeve të betonit të varrit të vjetër, groposjen e mbeturinave të varrimit, ndërtimin e varrit të ri me elemente betoni, vendosjen e kufomës bashkë me eshtrat, mbylljen e varrit me elemente betoni, mbulimin e varrit me dhe', vendosjen e bordurave prej betoni për konfigurimin e varrit dhe vendosjen e kokës së varrit me të dhënat e personit të vdekur. Vlera e këtij shërbimi shkon në 18,222 lekë.
- **Varrim me zhvarrim me qivure, persona me moshë deri në 10 vjeç** nënkupton prishjen e qivurit me skrapello dhe vare', largimin e inerteve (me dorë nga mungesa e infrastrukturës), zbulimin e varrit duke larguar dheun, hapjen e varrit duke larguar kapakët e betonit, nxjerrjen dizinfektimin dhe paketimin e eshtrave në beze tekstili, heqjen e elementeve të betonit të varrit të vjetër, groposjen e mbeturinave të varrimit, ndërtimin e varrit të ri me elemente betoni, vendosjen

e kufomës bashkë me eshtrat, mbylljen e varrit me elemente betoni, mbulimin e varrit me dhe', vendosjen e bordurave prej betoni për konfigurimin e varrit dhe vendosjen e kokës së varrit me të dhënat e personit të vdekur. Vlera e këtij shërbimi shkon në 22,332 lekë.

- **Varrim me zhvarrim me qivure, persona me moshë mbi 10 vjeç** nënkupton prishjen e qivurit me skrapello dhe vare', largimin e inerteve (me dorë nga mungesa e infrastrukturës), zbulimin e varrit duke larguar dheun, hapjen e varrit duke larguar kapakët e betonit, nxjerrjen dizinfektimin dhe paketimin e eshtrave në beze tekstili, heqjen e elementeve të betonit të varrit të vjetër, groposjen e mbeturinave të varrimit, ndërtimin e varrit të ri me elemente betoni, vendosjen e kufomës bashkë me eshtrat, mbylljen e varrit me elemente betoni, mbulimin e varrit me dhe', vendosjen e bordurave prej betoni për konfigurimin e varrit dhe vendosjen e kokës së varrit me të dhënat e personit të vdekur. Vlera e këtij shërbimi shkon në 28,588 lekë.
- **Zhvarrim pa qivur** nënkupton heqjen e bordurave të betonit, zbulimin e varrit duke larguar dheun, hapjen e varrit duke larguar elementët e betonit, nxjerrjen dizinfektimin dhe paketimin e eshtrave në beze tekstili, heqjen e elementeve të betonit të varrit të vjetër, groposjen e mbeturinave të varrimit dhe mbulimi i gropës me dhe'. Vlera e këtij shërbimi shkon në 5,978 lekë.
- **Zhvarrim me qivur** nënkupton prishjen e qivurit me skrapello dhe vare', largimin e inerteve (me dorë nga mungesa e infrastrukturës), zbulimin e varrit duke larguar dheun, hapjen e varrit duke larguar kapakët e betonit, nxjerrjen dizinfektimin dhe paketimin e eshtrave në beze tekstili, heqjen e elementeve të betonit të varrit të vjetër, groposjen e mbeturinave të varrimit dhe mbulimi i gropës me dhe'. Vlera e këtij shërbimi shkon në 16,422 lekë.

Shërbimi i varrimit do të ofrohet vetëm për qytetin e Beratit. (Varrezat Burdullias, Suelas, Varrezat e Dëshmorëve.)

Kosto e shërbimit të varrimit për një person mbi moshën 10 vjeç

Nr.	Nr.An	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	2.15a+an	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategori IV, h=1.5m	m3	3	1,468	4,404
2	An	Vendosje veshje pllaka betoni dhe mbyllje varri	lek	1	630	630
3	2.1a+an	Transport dheu me krahe deri ne 1 km	m3	1.8	1,159	2,086
4	An	Materiale(pllaka betoni 15 cope)				7,500
5		Tabele e etiketes se varrit				500
6		Te tjera materiale te domosdoshme, 13 %				1040
SHUMA TOTALE						16,160

Kosto e shërbimit të varrimit për një person deri në moshën 10 vjeç

Nr.	Nr.An	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	2.15a+an	Germim e mbushje dheu me krah per kanale kategori IV, h=1.5m	m3	1	1,468	1,468
2	An	Vendosje veshje pllaka betoni dhe mbyllje varri	lek	1	630	630
3	2.1a+an	Transport dheu me krahe deri ne 1 km	m3	0.43	1,159	495
4	An	Materiale(pllaka betoni)				6,000
5		Tabele e etiketes se varrit				500
6		Te tjera materiale te domosdoshme, 13 %				845
SHUMA TOTALE						9,938

Kosto e Varrim me zhvarrim pa qivure, persona me moshë deri në 10 vjeç

Nr.	Nr.An	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	An	Prishje pllakave te betonit +hapje varri	lek	1	636.52	636.52
2	2.15a+an	Germim e mbushje dheu me krah	m3	0.85	1,468	1,248
3	An	Heqje eshtrash , vendosje ne jastek tekstile+dezinfektim	lek	1	848.7	848.7
4	2.1a+an	Transport materiale me krah deri ne 1 km	m3	0.6	1,159	695
5	An	Vendosje veshje pllaka betoni dhe mbyllje varri	lek	1	630	630
6	An	Materiale(pllaka betoni)				6,000
7		Tabele e etiketes se varrit				500
8		Kellef tekstil per paketimin e eshtrave				350
9		Dizifektant per eshtrat (klor)	kg	1	150	150
10		Te tjera materiale te domosdoshme,				910
SHUMA TOTALE						11,968

Kosto e Varrim me zhvarrim pa qivure, persona me moshë mbi 10 vjeç

Nr.	Nr.An	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	An	Prishje pllakave te betonit +hapje varri	lek	1	636.52	636.52
2	2.15a+an	Germim e mbushje dheu me krah	m3	2.8	1,468	4,111
3	An	Heqje eshtrash , vendosje ne jastek tekstile+dezinfektim	lek	1	848.7	848.7
4	2.1a+an	Transport materiale me krahe deri ne 1 km	m3	1.2	1,159	1,391
5	An	Vendosje veshje pllaka betoni dhe mbyllje varri	lek	1	630	630
6	An	Materiale(pllaka betoni 15 cope)				7,500
7		Tabele e etiketes se varrit				500
8		Kellef tekstil per paketimin e eshtrave				350
9		Dizifektant per eshtrat (klor)	kg	1	150	150
10		Te tjera materiale te domosdoshme				2105
SHUMA TOTALE						18,222

Kosto e Varrim me zhvarrim me qivure, persona me moshë deri në 10 vjeç

Nr.	Nr.An	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	An	Shkallmim i qivurit me krahe	lek	1	4667.8	4667.8
2	An	Prishje pllakave te betonit +hapje varri	lek	1	636.52	636.52
3	2.15a+an	Germim e mbushje dheu me krah	m3	1.3	1,468	1,909
4	An	Heqje eshtrash , vendosje ne jastek tekstile+dezinfektim	lek	1	1692	1692
5	2.1a+an	Transport materiale me krahe deri ne 1 km	m3	2.5	1,159	2,897
6	AN	Vendosje veshje pllaka betoni dhe mbyllje varri	lek	1	630	630
7	AN	Materiale(pllaka betoni)				6,000
8		Tabele e etiketes se varrit				500
9		Kellef tekstil per paketimin e eshtrave				350
10		Dizifektant per eshtrat (klor)	kg	1	150	150
11		Te tjera materiale te domosdoshme				2900
SHUMA TOTALE						22,332

Kosto e Varrim me zhvarrim me qivure, persona me moshë mbi 10 vjec

Nr.	Nr.An	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	An	Shkallmim i qivurit me krahe	lek	1	4667.8	4667.8
2	An	Prishje pllakave te betonit +hapje varri	lek	1	636.52	636.52
3	2.15a	Germim e mbushje dheu me krah	m3	3	1,468	4,404
4	An	Heqje eshtrash , vendosje ne jastek tekstile+dezinfektim	lek	1	1692	1692
5	2.1a	Transport materiale me krahederi ne 1 km	m3	2.5	1,159	2,897
6	AN	Vendosje veshje pllaka betoni dhe mbyllje varri	lek	1	630	630
7	AN	Materiale(pllaka betoni 15 cope)				7,500
8		Tabele e etiketes se varrit				500
9		Kellef tekstil per paketimin e eshtrave				350
10		Dizifektant per eshtrat (klor)	kg	1	150	150
11		Te tjera materiale te domosdoshme,				5160
SHUMA TOTALE						28,588

Kosto e Zhvarrim pa qivure

Nr.	Nr.An	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	An	Prishje pllakave te betonit +hapje varri	lek	1	424.35	424.35
2	2.15a+an	Germim e mbushje dheu me krah	m3	2	1,468	2,936
3	An	Heqje eshtrash , vendosje ne jastek tekstile+dezinfektim	lek	1	848.7	848.7
4	2.1a+an	Transport materiale me krahe deri ne 1 km	m3	1	1,159	1,159
8		Kellef tekstil per paketimin e eshtrave				350
9		Dizifektant per eshtrat (klor)	kg	1	150	150
10		Te tjera materiale te domosdoshme				110
SHUMA TOTALE						5,978

Kosto e Zhvarrim me qivure

Nr.	Nr.An	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	An	Shkallmim i qivurit me krahe	lek	1	4667.8	4667.8
2	An	Prishje pllakave te betonit +hapje varri	lek	1	636.52	636.52
3	2.15a	Germim e mbushje dheu me krah	m3	3.5	1,468	5,138
4	An	Heqje eshtrash , vendosje ne jastek tekstile+dezinfektim	lek	1	1692	1692
5	2.1a+an	Transport materiale me krahe deri ne 1 km	m3	2.5	1,159	2,897
9		Kellef tekstil per paketimin e eshtrave				350
10		Dizifektant per eshtrat (klor)	kg	1	150	150
11		Te tjera materiale te domosdoshme				890
SHUMA TOTALE						16,422

9. SHËNIME TË PËRGJITHËSHME SHPJEGUESE

Për llogaritjen e kostos së shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të varrezave të dëshmorëve dhe shërbimit të varrimit në Bashkia Berat

- Në analizat e kostos, shpenzimet për pagat e punëtorëve të shërbimeve janë llogaritur sipas VKM Nr. 717 date 23.06.2009 “Për Pagat e Punonjësve Mbështetës të Institucioneve Buxhetore dhe të Nëpunësve të disa Institucioneve Buxhetore” i ndryshuar, pikat 2, 7, lidhja II. Niveli i pagës është llogaritur maksimumi i mundshëm (vjetërsia në punë 25 vite) Për rojet është parashikuar shtesa mbi pagë, për punën e kryer jashtë kohës normale të punës, në ditë festash , etj.
- Në analizat e kostos, shpenzimet për pagën e Përgjegjësit/mbikqyrësit të shërbimit është llogaritur sipas VKM Nr. 177, datë 8.3.2017 “Për Disa Ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 165, datë 2.3.2016, “Për Grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për Efekt Page, dhe Caktimin e Kufijve të Pagave të Funkionarëve të Zgjedhur e të Emëruar, të Nëpunësve Civilë e të Punonjësve Administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. Niveli i pagës është llogaritur maksimumi i mundshëm (vjetërsia në punë 25 vite). Duke e vlerësuar si shërbim i ndjeshëm, synojmë që ky pozicion pune të kryhet nga një profesionist me eksperiencën e duhur në këtë fushë.
- Në analizat e kostos, niveli i kontributeve për sigurimet shoqërore është llogaritur 16.7%.
- Analizat e kostos së materialeve janë llogaritur mbi bazën e të dhënave bazë, normave të konsumit, sipas vlerësimeve dhe informacioneve të dhëna nga anëtarët e komisionit sipas detyrave përkatëse.
- Në analizat e kostos, në llogaritjen e kostos së shërbimeve është zbatuar çmimi i tregut të materialeve.
- Në analizat e kostos, nuk janë marrë në konsideratë kostot e transportit, pasi do të mbulohen me mjetet aktuale të ndërmarrjes së shërbimeve.

Berat më 26/11/2021

RELACION MBI ZBATIMIN E URDHËRIT TË BRENDSHËM NR.509 DATË 15/09/2021,
NDRYSHUAR ME URDHËRIN NR.646 DATE 26/11/2021

Në mbështetje dhe zbatim të urdhërit të brendshëm të Kryetarit të Bashkisë Berat nr.509 datë 15/09/2021, të ndryshuar u ngrit Grupi i punës “Mbi përcaktimin e kostos për shërbimin e Mirëmbajtjes së Varrezave Publike, Mirëmbajtjes së Varrezave të Dëshmorëve dhe Shërbimin e Varrimit, në Bashkinë BERAT”.

Në zbatim të tij u punua për realizimin e plotë të studimit me tematikën e përcaktuar në urdhër dhe për të gjitha detyrat që përcaktoheshin në zbatim të tij.

Përveç konsultimeve dhe analizave të përbashkëta secili anëtar ndoqi respektivisht detyrat e përcaktuara:

N/ Kryetarët do të udhëheqin gjithë ecurinë e studimit të varrimit.

Drejtoria e Emergjencave Civile, Transportit dhe Pronave – Ndoqi ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit deri në hartimin e materialit përmbledhës të studimit.

Drejtoria e Finances – Përlllogaritjen, kalkulimin e kostos së shërbimit për njësi shërbimi.

Drejtoria Juridike – Baza ligjore për çdo argument ekonomik e juridik pjesë e materialit të studimit.

Drejtoria e Urbanistikës – Përlllogaritja e sipërfaqeve totale, distancat, vendodhjen e varrezave, Hartat e plota treguese të secilit zë shërbimi.

Kryetarët e njësive administrative dhe lagjeve – Ndjekje të procesit për secilën njësi në mbështetje të grupit të punës.

Jorida Papa – Statistikat , grumbullimin dhe hedhjen e të dhënave.

Llazar Hoxholli – Përcaktimin e volumeve të punës në varrezat publike, Dëshmorëve dhe specifikimet teknike.

Grupi i punës kreu me korektesë punën deri në përgatitjen e materialit përmbledhës të studimit.

Në dosjen e materialit studimor përfshihen të gjitha materialet dhe konkluzionet respektive.

Materiali u përgatit ne 4 kopje dhe u firmos nga të gjithë anëtarët e grupit të punës.

GRUPI I PUNËS :

- Luçiano Bojaxhiu
- Arjan Shkembi
- Erlin Kuçi
- Denada Gjogu
- Ergi Gjymshana
- Edona Baro
- Llazar Hoxholli
- Rovena Shehu
- Sokol Toska
- Miltiadh Kushi
- Petro Sinjari
- Erinda Toto
- Anxhelo Dhima
- Frenci Ceca
- Dejini Zylyftari
- Jorida Papa
- Mirel Konomi
- Joana Melengu
- Kliti Koroni
- Englinson Qose
- Shkelqim Hadaj
- Admir Grembi
- Mirjan Dalipaj

Kryetar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar